

nr.7570/1, (bashkëlidhur kopje e shkresës) informon ndërmjet të tjerave institucionin e Avokatit të Popullit se:

Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë, ka kryer veprimet e nevojshme hetimore proceduriale, pas informimit nga Posta Shqiptare, Filiali i Qendrës Tranzite Tiranë. Është përpiluar dhe vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik, dhe në konkluzionet e aktit të ekspertimit teknik nr.181, datë 21.06.2017, ka rezultuar se *“të dy armët objekt ekspertimi janë imitim armë zjarri të fabrikuar që nuk klasifikohen në asnjë nga kategoritë e armëve të zjarrit dhe armëve sportive”*.

Nisur nga sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr.7590 Prot, datë 18.09.2017, ka dërguar vendimin e datës 01.08.2017, për mosfillimin e procedimit penal dhe kthimin e armëve personit që i përkasin shtetasit D.Z. Armët e sekuestruara aktualisht ndodhen në Komisariatin e Policisë nr.4 Tiranë.

Nga ana tjetër jeni në dijeni dhe të faktit se më datë 05.12.2017, me shkresën nr. K2/D18-3, i kemi kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe duke konstatuar vonesa në kthimin e përgjigjes, Ndhmëskomisioneri i Avokatit të Popullit z.Petrit Azemaj ka komunikuar me prokurorin e çështjes z.Endrit Bimi, i cili sqaroi se për këtë rast kishte marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal.

Nga studimi i përmbajtjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.7590/2017, marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 01.08.2017, rezultoi se për armët e sekuestruara, nga ana e Policisë Gjyqësore është kryer ekspertimi teknik nr.181 datë 21.06.2017, në konkluzionet e të cilit thuhet: *“ të dy armët objekt ekspertimi janë imitim armë zjarri të fabrikuar, që nuk kualifikohen në asnjë nga kategoritë e armëve të zjarrit dhe armëve sportive ”*. Prokurori në këtë vendim arsyeton: *“...duke qënë se sipas aktit të ekspertimit teknik të sipërpërmëndur, rezulton se dy armët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret teknike të armës së zjarrit dhe për rrjedhojë, mbajtja e tyre nuk kërkon pajisjen me ndonjë lejë të posaçme, si i tillë fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.”*

Më datë 18.09.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë i ka dërguar shkresën nr.7590, Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë, me lëndë: *“Dërgohet për ekzekutim vendimi për mosfillimin e procedimit penal”* me këtë përmbajtje: *“Bashkëlidhur dërgojmë për njoftim një kopje të vendimit të datës 01.08.2017, në të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr.7590/2017, dhe kthimin e armëve të sekuestruara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Artan Azizaj”*. Ky urdhërim ligjor i prokurorit ende nuk ka gjetur zbatim nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë.

Duke analizuar në tërësi ankesën e qytetarit D. Z., aktet e adminstruara dhe përgjigjen e Komisarariatit të Policisë Nr.4 Tiranë, arrijmë në disa konstatime dhe përfundime:

Së pari: Në respektimin korrekt nga ana e Prokurorit, të dispozitave proceduriale, për sekuestrimet dhe disponimin e sendeve prova materiale të sekuestruara.

Këto dispozita parashikojnë detyrimin e organit procedues për nxjerrjen e urdhërit për kthimin e sendeve prova materiale, të sekuestruara dhe më pas, ndjekjen me qëllim zbatimi të urdhërit.

Kjo për faktin se në nenin 190 pika 1, gërma “ç” i Kodit të Procedurës Penale “Disponimi për provat materiale”, përcaktohet se prokurori në vendimin që merr cakton se çfarë duhet të bëhet me provat materiale duke urdhëruar, në rastin konkret sipas Pikës 1 gërma “ç”,

“kthimin e sendeve personave që u takojnë, dhe kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykatata”.

Në nenin 217 të Kodit të Procedurës Penale thuhet: *“Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestrës për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyerat”.*

Në pikën 3 të nenit 218 të Kodit të Procedurës Penale thuhet: *“Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhëri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë”.*

Ndërsa në nenin 463 i Kodit të Procedurës Penale Veprimet e Prokurorit, thuhet: *“Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit....”.*

Së dyti: Në zbatimin e urdhërimeve ligjore të Prokurorit, nga Policia Gjyqësore, e Policisë së Shtetit.

Në nenin 1 të Ligji nr.8331 datë 21.4.1998, i ndryshuar thuhet: *“Ky ligj ka për objekt vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe urdhërimeve të tjera ligjore...”.* Kurse në nenin 8, të ligjit, Përgjegjësia e Organeve të Ekzekutimit, thuhet: *“Organet dhe punonjësit që ekzekutojnë vendimet sipas këtij ligji janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit”.*

Pavarësisht mënyrës së formulimit të urdhërit për kthimin e sendeve provë materiale, shkresa e Prokurorisë është e qartë dhe detyruese për Policinë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë nr.4 *“për ekzekutimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.7590/2017, dhe kthimin armëve sekuestruar nga O.P.GJ z.Artan Azizaj”.*

Së treti: Në mosrespektimin nga organet shtetërore të rrugës ligjore në rast konflikti, dhe zvarritjen e procedurave për kthimin e sendeve të sekuestruara, me pasoja në cënimin e të drejtave të njeriut

Në konkluzionet e aktit të ekspertimit teknik nr.181, datë 21.06.2017, thuhet qartë se: *“të dy armët objekt ekspertimi janë imitim armë zjarri të fabrikuar, që nuk kualifikohen në asnjë nga kategoritë e armëve të zjarrit dhe armëve sportive”.*

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal, gjithashtu në mënyrë eksplicite sqaron se *“dy armët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret teknike të armës së zjarrit dhe për rrjedhojë, mbajtja e tyre nuk kërkon pajisjen me ndonjë lejë të posaçme”.*

Duke iu referuar Ligjit nr.74/2014 “Për armët” neni 3, pika 3 *“Armë qitjeje, është çdo lloj armë dore me tytë që nxjerr jashtë një shkrepje ose një predhë, nëpërmejt veprimit të forcave që nuk janë krijuar nga ndezja e një lënde djegëse shtytëse. Konsiderohet armë qitjeje ajo armë predha e së cilës ka një energji, të matur gjatë fluturimit, të barabartë ose më të lartë se 7.5joule”;* pika 24 **“imitim arme”**, është mjeti, dukja e jashtëme e të cilit ngjason me atë të armës, por që nuk mund të përdoret si armë zjarri apo nuk mund të prodhohet pa ndonjë mekanizëm të nevojshëm të qitjes e as që mund të përshtatet për qitje”; neni 4 pika 3, c **“Nuk njehsohen si armë sipas këtij ligji...c)imitimet e armëve”.** Gjithashtu armët e kategorisë “C” janë armë me kalibër 4.5 mm dhe energji 7.5 joule. Objektet në fjalë janë imitime, të cilat nën veprimin e gazit lëshojnë një sferë plastike 5.99 mm, me një energji maksimale 1.2 joule, e përcaktuar në manualin përkatës të objektit, i cili shpjegon detajet teknike. Pra, këto objekti sikurse shprehet dhe eksperti shkencor janë imitime armësh.

Prandaj çdo argumentim tjetër siç është dhe ai që pasqyrohet në përgjigjen e Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë, nuk qëndron kjo dhe për faktin se konflikti nuk është bërë objekt gjykimi.

Jeni në dijeni të faktit se, më datë 12.08.2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit referuar nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit nr.4, ka rregjistruar materialin kallëzues nr.9968, për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal. Ky material bën fjalë për faktin se gjatë kalimit në skanerin e postës dhe doganës, është aprë imazhi i një arme në një objekt postar i cili kishte ardhur nga Hong Kongu për shtetasin D. Z

Sipas aktit të ekspertimit teknik nr.272, datë 31.08.2016, rezulton se *arma objekt ekspertimi është imitim arme (pistoletë lodër me sfera plastike) dhe është në gjëndje të rregullt teknike . Ajo nuk është armë zjarri por imitim i tyre.*

Mi këtë bazë më datë 25.10.2016, organi i Prokurorisëka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se “ *ekziston një fakt i cili nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*”.

Më datë 21 Nëntor 2016, Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë, bazuar në urdhërin e prokurorit, i ka kthyer sendin e sekuestruar qytetarit D. Z.

Pra, siç shifet edhe pse nga konkluzioni i ekspertëve shkencorë del qartë se armët objekt ekspertimi nuk janë armë zjarri por imitim i tyre, për të cilat nga organi i Prokurorisë është marrë vendim mosfillimi procedimit penal, Policia Gjyqësore mban dy qëndrime të ndryshme. Konkretisht, për njërin rast zbatohen dispozitat procedurale, ndërsa për rastin tjetër analog ndodh e kundërta.

Moszbatimi i urdhërimeve ligjore të prokurorit nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit, dhe zvarritja e procedurave për kthimin e sendeve të sekuestruara, krijojnë pengesa në zhvillimin normal të aktivitetit të qytetarit D. Z.

Sa sipër duke gjetur se ankesa e z.D. Z., është e drejtë, bazuar në nenin 21 shkronja “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku thuhet: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOHET

“Marrja e masave për kthimin e sendeve të sekuestruara shtetasit D. Z., në zbatim të shkresës nr.7590/2017, datë 18.09.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Mbi masat e marra në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na dërgoni përgjigje brënda 30 ditëve, parashikuar nga neni 22 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

Konc.&Dakt.P.A.
Tiranë më 05.02.2018

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI